



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 808 Prot.

Tiranë, më datë 17.08.2020

VENDIM

Nr. 264, datë 17.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, neni 134, pika 1, Neni 40, pika 2, Konventa e Trashëgimisë Kulturore 1972 dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit dhe raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 17.08.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Kapanon për grumbullimin dhe përpunimin e mandarinave, Xarrë, Bashkia Konispol”, me investitor “Agrokulturë Xarrë” sh.p.k.;
 - Projekti duhet depozituar në gjuhën angleze, pasi në cilësinë e shtetit palë në Konventën Trashëgimisë Kulturore 1972 në zbatim të paragrafit 172 të Udhëzuesit Operacional, do të shqyrtohet në UNESCO;
 - Projekti duhet të shqyrtohet dhe nga Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore;
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

